



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
SH.A. "PORTI DETAR" SHËNGJIN

Nr. 338 Prot.

Lezhë, më 30 . 06 . 2025

RAPORTI I ECURISË SË VEPRIMTARISË

Përshkrim i shoqërisë

Shoqëria "Porti Detar Shëngjin" Sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregetar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë me Vendimin nr. 21234, datë 29.04.1999. Është themeluar si një shoqëri anonime me kapital fillestar 73.820.000 lekë. Me urdhërin e METE Nr 429 datë 10.06.2008 kapitali themeltar i shoqërisë bëhet 188.995.000 lekë gjëndje me 31.12.2008.

Me shkresën e METE Nr 209711 datë 17.04.2009 është bërë rivlerësimi i truallit nga ekspertiza kontabël e regjistruar me 28.12.2009 dhe kapitali themeltar i shoqërisë me 31.12.2009 është 571.268.000 lekë me shkresën nr 207 datë 24.03.2010 dhe me urdhërin nr 670 datë 16.09.2011 kapitali themeltar i shoqërisë bëhet 632.906.000 lekë.

Me shkresën e METE Nr 600011 Prot. datë 25.07.2013 është bërë miratimi i bilancit dhe shpërndarja e fitimit për vitin 2012. Në mbështetje të këtij urdhëri është bërë dhe rritje e kapitalit me urdhërin e METE Nr 719 datë 04.09.2013 dhe kapitali i shoqërisë nga 632.906.000 lekë bëhet 656.924.000 lekë.

Me Urdhërin e datës 30.07.2018, për miratimin e bilancit dhe shpërndarjen e fitimeve të vitit 2017 dhe Urdhërin të datës 18.09.2018 për miratimin e zvogëlimit të kapitalit vlera e Kapitalit nga 656.924.000 lekë është bërë 569.562.000 lekë.

Me Urdhërin e datës 29.07.2020, për miratimin e bilancit dhe shpërndarjen e fitimeve të vitit 2019 dhe vendimin të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve me Nr.156., datë 15.10.2020, për miratimin e zvogëlimit të kapitalit vlera e kapitalit nga 569.562.000 lekë është bërë 528.241.000 lekë, vlera e cila deri me datën 31.12.2024 nuk ka pësuar ndryshime.

Sh.a Porti Detar Shëngjin nuk është e organizuar në filiale apo degë.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqërisë për ushtrimin 2024 është Ngarkim shkarkim mallrash, dhe depozitim mallrash.

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet me:

- Statutin

- Ligji 9901, date 14.04.2008 "Për tregetarët dhe shoqëritë tregëtare".
- Ligji 7661 date 19.01.1993 "Per Kontabilitetin" ndryshuar me Ligjin 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"
- Legjislacioni fiskal.
- Ligje dhe akte të tjera ligjore e nënligjore të shtetit shqiptar në fuqi.

1.1 Pronësia dhe Organet Drejtuese të Portit Shëngjin sha

Organet e larta drejtuese të shoqërise paraqiten si vijon:

- Asambleja e Aksionerit
- Këshilli Mbikqyrës
- Drejtoria e Përgjithshme

a)	Shoqëria Porti Shëngjin zotërohet 100% nga aksioneri i vetëm si më poshtë:
----	--

Emri i aksionerit	Vlera e Kapitalit	% e kapitalit
Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.	528.241.000	100

Përbërja e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë është si më poshtë:

- znj. Mimoza Dhëmbi (Kryetare)
- z. Ismet Lala (Anëtar)
- znj. Erjola Muka (Anëtare)

Administratori ligjor i shoqërisë është z. Sandër Marashi i cili është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë me të tretët.

Adresa e Selisë ligjore të Shoqërisë është: Shëngjin Lezhe.

NIPT-I është J67902539F

Është e regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Lezhe me NIPT J67902539F.

Politikat dhe objektivat e menaxhimit financiar

Ndër politikat dhe objektivat e menaxhimit financiarë është përcaktimi i qartë dhe zbatimi i të gjitha kërkesave ligjore e akteve nënligjore nepërmjet rregulloreve edhe udhëzimeve .

Përmbledhje e politikave kontabël

Bazat e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elementë të metodave të tjera dhe parimit të të drejtave të kostatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("lekë"). ***Në paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit 2024 është zbatuar formati i SKK-2 Parimet kontabël më domethënëse që janë përsorur nga shoqëria paraqiten si më poshtë:***

Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e shërbimeve ngarkim shkarkimit njihen kur i janë kaluar bleresit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmeri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varesi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlllogaritet me besueshmëri. Te ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së faturuar dhe të arkëtuar ose të arkëtueshme. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tretëve dhe në të njëjtin ushtrim kontabël me të ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin **zyrtar** të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në cdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja e realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja me kryesore, me 31.12.2024 janë: **1 euro = 98.15 lekë.**

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit të paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili nuk ndryshon nga fitimi tregetar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 01 Janar – 31 Dhjetor 2024. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2024 është 15 %.

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në para regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto.

Pasivet financiare

Huatë e parapagimet Furnitorët, për t'u shlyer në para, në përgjithësi, mbahen në bilanc në vlerën e tyre bruto të mbështetur (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivitet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivitet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalin aksionar. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Amortizimi është llogaritur mbi bazën e vlerës së mbetur si për ndertesat dhe për pjesën tjetër të

aktiveve të qëndrueshme. Normat e përdorura janë në ndertesa 5 % të vlerës fillestare minus amortizimin e akumuluar dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur, aktivet afatgjata jo materiale 15% dhe paisje informatike 25% e vlerës fillestare.

Gjendjet e inventaret

Vlerësimi në hyrje i inventareve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjelle inventarët në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është cmuar si vlera neto të realizueshme.

Vlerat e inventarit të paraqitura më sipër përputhen me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike e kryer në fund të ushtrimit 2024.

Veprimet ekonomike që lidhen me hyrjet e daljet janë tranzituar në llogaritë e rezultatit me menyrën e inventarit të përhershëm.

Shuma e inventarit të paraqitur në " Lëndë e parë" përfaqëson stokun e materialeve që përdoren në procesin e mirëmbajtjes së mjeteve të ngarkim shkarkimit, të vlerësuara me koston e blerjes. Drejtimi mendon se vlera e paraqitur është vlera me e ulët mes koston së marrjes dhe vlerës neto të realizueshme dhe nuk është nevoja për zhvleresime të tij.

Aktive monetare (likuiditete në arkë dhe bankë).

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarët fizikë të monedhave. Tepërcat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në lekë duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të ushtrimit të bankës së Shqipërisë. Gjendjet e mjeteve monetare në bankë dhe arkë, në lekë dhe valutë, në datat 31 Dhjetor 2024 janë si më poshtë:

Nr	Emri Bankës	Nr llog	Monedha	Vlera në Valute	Kursi këmbimit fund viti	Vlera në lekë
1	Raiffeisen Bank	1100000414	Leke			1'264'210.27
2	Raiffeisen Bank	8001164681	Euro	7'777.80	98.15	38'484.42
3	Otp Bank	4250	Leke			588'376.26
4	Otp Bank	213802	Euro	669.12	98.15	65'674.00
5	Bkt	418073174	Leke			2'111'579.66
6	Union Bank	-	Leke			255.00
	Totale					4'793'486.00

1	Arka					0
---	------	--	--	--	--	---

Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Në "Llogarinë Kërkesa të arketueshme" janë pasqyruar faturat e pa arketuara për shitje shërbimesh që shoqëria ka gjendje më 31.12.2024 në shumën 12'887'994 lekë. Kjo shumë përfaqësohet nga detyrimi i firmave :

- Rafaelo 2002 sha, Tiranë 3,393,893 lekë nga përpunimi i anijeve dhe 15,994 Euro si axhensi detare për tarifa portuale.
- Shega Trans, 1,667 Euro.
- Aurel Preka, 910 Euro.
- Keli Inerte 1,983,476 leke.
- CN-ADR shpk, Tirane 120,000 leke Qira.
- Axhensia Orjon 345,464 leke për Kleit Marvi, 82.2 Euro tarife portuale.
- M.S 2011 Lezhe 401,856 Leke.
- Beato Anibale Lezhe 726,731 leke.
- Axhensia Iridiani e Kadeli 1,647,086 leke nga përpunimi i anijeve.

Shumat e paraqitura në "Llogari Kërkesa të tjera të arketueshme" përfaqësojnë tepricën debitoare të "Shteti tatim mbi fitimin" më 31.12.2024 me 7,727,388 lekë si dhe tepricën e TVSH në shumën 7,033,619 leke.

Drejtimi mendon se të gjitha Kërkesat do të arketohen në një periudhë afatshkurter me vlerën e tyre nominale dhe nuk parashikon rënie në vlerë.

Aktivitet Afatgjatë Materiale AAM-te

Vlerat dhe klasifikimi në grupe të AAM-ve të pasqyruara në bilanc janë të perputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të muajit dhjetor 2024. Si politike kontabel për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e kostos (SNK -5). Vlerësimi fillestar në momentin e marrjes në inventar është bërë me koston e marrjes dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar.

Në gjendjen dhe levizjen e AAM-ve janë pasqyruar dhe investimet në proces të objektit "Rehabilitimi i Portit Detar Shengjin Kalata e Re" për vitin 2024 është me vlerë 236,660,630 lekë.

Pasivitet Afatgjatë

Grantet dhe te ardhurat e shtyra ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2024 paraqiten si vijon:

Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit ne shumen 695,739 leke e cila është e mbartur nga vitet e mëparshme.

"Te pagueshme ndaj furnitoreve" përbën detyrimin ndaj furnitorëve në shumën prej 471.344 për "C.E.C shpk" Tirane.

Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor.

Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht. "Te pagueshme ndaj punonjesve" rezultojne ne shumen 0 leke per paga te punonjesve me daten 31.12.2024.

"Detyrimet tatimore + sig.shoqerore" perfaqesojne, tatimit (TAP) dhe tatimi ne burim 266'065 leke, si dhe sigurimet shoqerore e shendetesore te muajit dhjetor 2024 ne shumen 1'200'430 leke.

Kapitalet e veta te shoqerise' i paraqitur ne bilanc me 31.12.2023 eshte 528.241.000 leke i cili gjatë vitit 2024 nuk ka pësuar ndryshime.

Te ardhura nga Rezerve Rivleresimi (rimarrje) eshte ne vleren 568.418.302 leke. Kjo shumë përbën vlerën e amortizimit të AAM për diferencën e rivlerësuar.

Rezervat ligjore ishin 15.557.711 leke me 31.12.2023 dhe gjatë vitit 2024 nuk kanë pësuar ndryshime, dhe në fund të vitit 2024 shuma është prej 15.557.711 lekë.

Rezerva te tjera:

Pra rezerva te tjera ne fund te vitit 2024 paraqiten me vleren 517.148 leke e mbartura nga viti i mëparshëm.

Humbje të pashpërndara është në shumën prej 180.173.812 lekë.

Humbja e vitit 2024 është në shumën 11.025.939 lekë.

Të ardhurat

Të ardhurat e realizuara gjatë ushtrimit, sipas segmenteve (kategorive) të biznesit paraqitet si vijon:

Ushtrimi i mbyllur	Ushtrimi i mbyllur	Ushtrimi i mbyllur
31 Dhjetor 2024	Dhjetor 2023	Dhjetor 2024
Te ardhurat nga shitja e produkteve	0	0
Te ardhurat nga kryerja e shërbimeve	42'957'992	58'354'886
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	617'000	1'214'000
Te ardhurat të tjera te ardhura financiare)	3'816'874	6'312'284
Shuma	47'391'866	65'881'170

Të ardhurat nga shitja e shërbimeve janë vlerësuar me vlerën e drejte të shumës së arketuar ose të arketueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja.

Paraqitja në pasqyrat financiare të ardhurave dhe shpenzimeve është bërë sipas natyrës së tyre.

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Jane paraqitur si difference të ardhurave me shpenzimet sipas kërkesave të standarteve.

Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2024 (155'747)	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2023 (156'304)	Të ardhurat nga interesat 0 Fitimet/Humbjet nga kursi i kembimit (155'747). Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 0. Shuma (155'747).
--	--	---

Shpenzimet e veprimtarisë kryesore

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e shërbimeve, të pasqyruara në dokumentat justifikues, janë regjistruar me shumën e paguara ose të pagueshme, materiale të konsumuara 585,223 lekë e ndare kjo në karburante dhe pjesë ndërrimi të materialeve të tjera.

Kostoja e punësimit, page dhe sigurime shoqërore është pasqyruar saktësisht si shpenzim me vlerën e realizuar dhe të dokumentuar 49.983.270 lekë, nga e cila pagat e punonjësve 42.697.003 lekë. Shpenzimet për sigurimet shoqërore në shumën prej 7.286.267 lekë.

Amortizimet e zhvlerësimet 21.284.393 lekë. Sipas natyrës së tyre shpenzimet e ushtrimit 2024 janë treguar në pasqyrën përkatëse, totali i shpenzimeve 76.907.267 lekë.

Shpenzime personeli.

Numri mesatar i punonjësve dhe pagat sipas kategorive kryesore janë si më poshtë:

Gjatë vitit 2024 kanë qënë në marrëdhënie pune gjithësej 73 punonjës ose 100 %. Fond page gjithësej i paguar është 42.697.003 lekë ose 100 % dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore 7.286.267 lekë. Paga mesatare për një punonjës është realizuar 48'749 lekë ose 100 % krahasuar me programin.

Janë bërë rregullisht ndalesat për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin për ushtrimin kontabel 2024 shoqëria nuk ka llogaritur pasi ka rezultuar me humbje në shumën prej 11.025.939 lekë.

Humbja e ushtrimit është i llogaritur si difference të ardhurave me shpenzimet, i cili është rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal.

Ngjarje pas datës së bilancit dhe vazhdimësia e shfrytëzimit

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

Lidhur me vijmësinë shoqëria rezulton me humbje për disa vite rresht por, kjo nuk ka cenuar vijmesinë e aktivitetit të shoqërisë.

Përgjegjëse Finance

Dorina Mash



DREJTORI

Sandër Marashi

